



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD.HOC PËR PËRZGJEDHJEN E
DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE
EDUKATIVO ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/eve dhe zëvendës drejtorëve/eve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për konkurset për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve sipas kërkesës së Drejtorit të DKA-Lipjan nr.01-112/02-29440 të datës 16.06.2025, në përbërje si vijon:

1. Brahim Duriqi, DKA, Kryesues
2. Besarta Trolli, eksperte e arsimit, anëtare dhe
3. _____ **Caktohet nga MASHT, anëtar**

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit përzgjedhës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përzgjedhës janë përzgjedhja e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/es së IEAAP, duke shikuar dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas procedurave të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve

profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (ieaa) të arsimit parauniversitar.

2. Mandati i anëtarëve është i përkohshëm ad.hoc dhe vlenë vetëm për konkurset për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në:

Drejtor në këto shkolla :

- SHFMU "Migjeni" në Rufci i Ri
- SHFMU "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve
- SHFMU "Skenderbeu" në Kraishtë
- SHFMU "Ibrahim Krasniqi" në Smallushë
- SHFMU "7 Marsi" në Poturoc
- SHML "Shaqir Hoxha" në Shalë
- SHFMU "Fehmi Agani" në Medvec
- SHFMU "Nezë Bujani" në Bujan
- ÇEAP "Çerdhja" në Lipjan

Zëvendës drejtor në këto shkolla :

- SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan
- SHFMU "Zenel Hajdini" në Gadime

Neni 3 **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-32378

Lipjan, më 30.06.2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

